

PROCESVERBAL

nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime

Mediatike Audio dhe Audiovizuele

mbajtur më 29.01.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Magdalena D. Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski e hapi seancën e 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:15 dhe u mbajt në ambientet e ASHMA-së, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski njoftoi ndryshim në renditjen e pikave në Rendin e ditës të propozuar, si vijon: Pika nr.5 - Propozim-vendim për shpallje të pavlefshme të Vendimit që lejon ndryshimin e strukturës së pronësisë të transmetuesit, të vihet si Pika 3, por me titull të ndryshuar – Propozim-aktvendim për ndërprerjen e procedurës për ndryshim të strukturës së pronësisë të transmetuesit dhe Kërkesë drejtuar Kuvendit të RMV-së për interpretim autentik. Pikat pas tij do të zhvendosen sipas radhës një numër më lart.

Drejtori Zoran Trajçevski propozoi një ndryshim shtesë të rendit të ditës, lidhur me pikën për rebalanc të Planit Financiar. Ai propozoi, pas propozimit të diskutuar me z.Trajçev, që seanca e 4-ët të mos mbahet, kështu që Pika “Propozim-vendim për dhënien e ndihmës financiare-donacion të Projektit për Efikasitet Energjistik për Institucionin Shëndetësor Publik SBGPM 13 Nëntor Shkup me Propozim-marrëveshje për donacion” të shtyhet, ndërsa Pika me titull “Propozim për dhënien miratim për miratimin e Vendimit për shërbim të mjeteve për qasje në Sistemin e Shpërndarjes së Internetit të Regjistrat Qendror”, të zhvendoset në Rendin e ditës për seancën e 3-të si pika e parafundit, para pikës Të ndryshme.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi të ndryshuar dhe korigjuar si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga Seanca e parë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 21.01.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 21.01.2025.
3. Propozim – aktvendim për ndërprerjen e procedurës për ndryshim të strukturës së pronësisë të transmetuesit dhe Kërkesë në Kuvendin e RMV-së për interpretim autentik.
4. Propozim për marrjen e vendit për Ribalanc të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025.
5. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë.
6. Propozim-vendim për shpallje të pavlefshme të vendimit që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë të transmetuesit.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Multimedija Network nga Gostivari për shkelje të nenit 141 paragrafi (13) të LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Multimedija Network nga Gostivari për shkelje të nenit 143 paragrafi (1) të LSHMAAV.
9. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Multimedija Network nga Gostivari për shkelje të nenit 144 paragrafi (3) të LSHMAAV.
10. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për pagesën e mjeteve për qasje në Sistemin e Shpërndarjes së Internetit të Regjistrimit Qendror.
11. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 6 vota "pro" miratoi Procesverbalin e propozuar të Seancës së parë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të mbajtur më 21.01.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 2-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të mbajtur më 21.01.2025.

Z. Fidanoski propozoi korrigjim në lidhje me formulimin në procesverbal, në faqen 4, konkretisht në pjesën që ka të bëjë me diskutimin e tij. Domethënë, fjalët "vënie në fuqi" duhet të ndryshohet në "vënie jashtë fuqisë" dhe ka dhënë shënim teknik për mbiemrin e tij, i cili duhet të shkruhet pa shkronjën "v".

Këshilli i Agjencisë, me korrigjimet e propozuara nga z. Fidanoski, me 6 vota "pro" miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të mbajtur më 21.01.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-aktvendimin për ndërprerjen e procedurës për ndryshimin e strukturës së pronësisë të transmetuesit dhe Kërkesën drejtuar Kuvendit të RMV-së për interpretim autentik. Ai theksoi se kjo pikë është diskutuar në seancat e kaluara për të shmangur pasojat e mundshme juridike nga moszbatimi i Vendimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë, të miratuar nga Këshilli para më shumë se 10 muajsh, të cilin transmetuesi "Televizioni Klani i Maqedonisë" ende nuk e ka zbatuar. Në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, propozoi ndërprerjen e procedurës, duke pasur parasysh se transmetuesi nuk ka paraqitur situatën e korrigjuar apo të krijuar rishtazi lidhur me ndryshimin e strukturës së pronësisë, edhe pse ka qenë i detyruar ta bëjë këtë. Po ashtu, për shkak të paqartësive në zbatimin e nenit 42 të LSHMAAV, propozoi që Agjencia, përmes Qeverisë së RMV-së si propozues i autorizuar, të kërkon interpretim autentik nga Kuvendi i RMV-së. Derisa të merret interpretimi autentik, ai ka propozuar që procedura të pezullohet përkohësisht.

Z. Petrusovski deklaroi se e pranon propozimin e drejtorit.

Z. Trajçev theksoi se bëhet fjalë për precedent në të cilin transmetuesi pas paraqitjes së kërkesës për ndryshim të strukturës së pronësisë, nuk e ka zbatuar ndryshimin në Regjistrin Qendror. Këshilli i Agjencisë e ka marrë vendimin në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga transmetuesi 10 muaj më parë. Megjithatë, pas një periudhe kohore, ende nuk është e qartë nëse baza mbi të cilën është marrë vendimi ka mbetur e pandryshuar dhe nëse zbatimi i vendimit do të ishte në përputhje me gjendjen aktuale faktike.

Ai theksoi se duhet të ndërmerren hapa të duhur për të shmangur mundësinë e zbatimit të vendimit të bazuar në të dhëna të vjetruara. Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAAV) nuk parasheh afat për zbatimin e vendimit të këtij lloji, ndoshta sepse ligjvënësi nuk ka pritur që subjekt me interes juridik të parashtrojë kërkesë dhe më pas të mos e zbatojë atë. Kjo situatë krijon një vakum ligjor në procedurë.

Në lidhje me mundësinë për shpalljen e pavlefshme të vendimit, është shqyrtuar zbatimi i nenit 124 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), por ai nuk jep arsye për një përfundim të tillë, pasi në mënyrë shteruese rendit kushtet në të cilat mund të zbatohet, si paligjshmëria, mungesa e kompetencave të organit dhe të ngjashme. Në rastin konkret, vendimi është marrë në përputhje me ligjin dhe në bazë të të dhënave të sakta dhe të plota të asaj kohe, ndaj nuk mund të zbatohet as neni 124 dhe as neni 122 i LPPA që i referohet shfuqizimit të vendimit.

Ai theksoi se zgjidhja e kësaj situatë duhet kërkuar në nenin 42, paragrafi (1) të LSHMAAV, që parasheh se Agjencia mund të anulojë një vendim nëse e njëjta është marrë në bazë të të dhënave të pasakta ose të paplota. Mirëpo, në rastin konkret fillimisht vendimi është marrë në bazë të të dhënave të sakta dhe të plota, por lind pyetja nëse ato mbeten të tilla edhe pas 10 muajve të kaluar?

Për shkak të kësaj dileme ligjore, ka pranuar propozimin për të kërkuar interpretim autentik nga ligjvënësi, pasi Agjencia nuk ka kompetencë për interpretim të gjerë të ligjit në këtë kontekst. Nëse ligjvënësi konstaton se në rast të tillë të dhënat nuk mund të konsiderohen më të sakta dhe të plota, atëherë Këshilli do të kishte bazë ligjore për anulimin e vendimit në përputhje me nenin 42 paragrafi (1) të LSHMAAV. Në të kundërt, nëse ligjvënësi konstaton se kjo dispozitë nuk mund të zbatohet, vendimi do të mbetej në fuqi duke krijuar një vakum ligjor në sistem.

Gjithashtu, z. Trajçev theksoi se transmetuesi, për të cilin vlen vendimi, nuk duhet të dëmtohet apo të vendoset në pozitë të pafavorshme juridike. Nëse ka interes ligjor, në çdo kohë mund sërish të paraqesë kërkesë për ndryshim të strukturës së pronësisë, e cila do të shqyrtohet në bazë të gjendjes aktuale. Përndryshe, është e mundur që vetë transmetuesi të heqë dorë nga qëllimi për ndryshim, por Agjencia nuk ka mekanizëm për ta përcaktuar këtë.

Ai konkludoi se është thelbësore që zbatimi i çdo vendimi të bazohet në të dhëna të sakta dhe të përditësuara në momentin e realizimit të tij. Kërkimi i interpretimi autentik është hap i domosdoshëm për të tejkaluar boshllëkun ligjor, duke qenë se neni 42 i LSHMAAV nuk parasheh mekanizëm të qartë për të vepruar në rrethana të tilla.

Z. Petrushevski tha se pajtohet me z.Trajçev në lidhje për korrigjimet e vogla në Kërkesën për interpretim autentik dhe është i pajtimit edhe për aktvendimin e propozuar për ndërprerjen e procedurës.

Z. Fidanoski theksoi se është e dukshme zbrazëtia juridike në rregullativën ligjore lidhur me këtë çështje, e cila çon në gjendje status-kvo, e cila, siç theksoi z. Trajçev, mund të shndërrohet në situatë " limbo " me pasoja potenciale negative. Këshilli, si organi që vendos për ndryshimin e strukturës së pronësisë, është i përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces dhe ka mundësi që në të ardhmen të përballet me implikime të caktuara ligjore për shkak të moszbatimit të vendimit. Ai pajtohet me korrigjimet e propozuara nga kolegu Trajçev, por theksoi se mbetet dilema nëse Këshilli mund të paraqesë kërkesë për interpretim autentik për të konstatuar gjendjen faktike apo për të ndërmarrë veprim juridik në bazë të kompetencës juridike. Në këtë kontekst, pyetja kryesore është nëse Agjencia ka autorizim për të anuluar vendim të marrë dhe nëse mund të ndërmarrë veprimet e duhura në përputhje me kompetencat e saj ligjore.

Z. Trajçev shpjegoi se kërkesa për interpretim autentik është formuluar si pyetje konkrete, p.sh. nëse një dispozitë e caktuar ligjore duhet të interpretohet në një mënyrë apo tjetër. Në rast të tillë, Kuvendi do të japë interpretim të qartë për zbatim të kësaj dispozite. Në rastin konkret, pyetja e propozuar do t'i referohej nenit 42, paragrafi (1) të LSHMAAV, ku termat kyç janë "të dhëna të pasakta dhe të paplota". Dilema thelbësore është nëse, duke pasur parasysh kohën e kaluar – në këtë rast 10 muaj – të dhënat mbi bazën e të cilave është marrë vendimi tani mund të konsiderohen të pasakta ose të paplota. Nëse interpretimi autentik përcakton se pas një periudhe të caktuar kohore të dhënat nuk janë më të sakta dhe të plota, Këshilli do të kishte bazë të marrë vendim për anulimin e vendimit të mëparshëm. Në rast të kundërt, nëse Kuvendi konstaton se kjo rregull nuk zbatohet, atëherë vendimi i mëparshëm mbetet në fuqi ligjore. Gjithashtu, meqenëse nuk është e mundur të parashikohet se sa do të zgjasë procedura për interpretim autentik, transmetuesi, nëse ka interes juridik, nuk duhet të presë përfundimin. Ai mund në çdo kohë të paraqesë kërkesë të re me të dhëna të përditësuara, në bazë të së cilës Këshilli do të mund të marrë vendim të ri. Si analogji për situatën e tilla, z.Trajçev përmendi nenin 91, paragrafin (2) të Ligjit për shoqëritë tregtare, i cili parasheh se nëse pas kalimit të tre muajve nga dita e plotësimit të kushteve për paraqitjen e kërkesës, po e njëjta nuk dorëzohet, Regjistri Qendror i RMV-së nuk do ta regjistrojë dhe do ta refuzojë.

Z. Fidanoski shprehu nevojën për shpjegim, duke thënë se nëse ka kuptuar drejtë, kërkesa për interpretim autentik në dispozitivin e saj duhet të thotë: " *Nëse të dhënat e dorëzuara nga transmetuesi që para 10 muajsh llogariten (konsiderohen) për të sakta dhe të plota apo jo?* duke e lënë pas formulimin shtesë që ka të bëjë me mundësinë e anulimit të

vendimit të marrë, me qëllim që kërkesa të mbetet e fokusuar vetëm në përcaktimin e saktësisë dhe plotësisë së të dhënave.

Z. Trajçev tha se do të kërkohej interpretim i nenit në drejtim të përcaktimit nëse skadimi i periudhe të caktuar kohore, e cila do të specifikohet në përputhje me situatën aktuale, mund të ndikojë në saktësinë dhe vlefshmërinë e të dhënave që kanë shërbyer si bazë për marrjen e vendimit. Në lidhje me aktvendimin e propozuar për ndërprerjen e procedurës, ai theksoi se nuk është futur në analizë të detajuar për shkak të mungesës së kohës për shqyrtimin e materialeve, por ka shprehur besimin se është përgatitur siç duhet nga shërbimet.

Z. Fidanoski deklaroi se e kupton fjalën e z.Trajçev dhe pajtohet që kërkesa për interpretim autentik të formulohet në mënyrën e propozuar. Në bazë të interpretimit të marrë do të merret vendim i duhur dhe procedura e vendimit të mëparshëm do të mbetet e pezulluar deri në zbardhjen e këtij boshllëku ligjor, i cili në të ardhmen mund të shkaktojë probleme.

Z. Ajdini theksoi se qëndrimin e tij për këtë çështje e kishte shprehur në seancën e kaluar. Ai shtoi se propozimet e sotme për korrigjimin e propozimit janë të pranueshme për të dhe se do t'i mbështesë.

Këshilli i Agjencisë, me vërejtjet nga z.Trajçev, të cilat do të përfshihen në Kërkesën për interpretim autentik të nenit 42 të LSHMAAV, njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës lidhur me Njoftimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup nr.0204-74 datë 23.02.2024, me plotësime nga data 29.02.2024 dhe data 15.03.2024 dhe Vendimin e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale PA1 nr.02-74 datë 21.03.2024 e cila lejon ndryshimin e strukturës së pronësisë së transmetuesit.

Pezullimi i procedurës do të zgjasë derisa organi kompetent - Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - të zgjidhë çështjen e mëparshme - duke ofruar interpretim autentik të nenit 42 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive - Anulimi i vendimit që lejon zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 4

Trajçevski shpjegoi Propozimin për miratimin e vendimit për Ribalanc të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025. Ai shpjegoi se ndryshimet e propozuara në Planin Financiar kanë të bëjnë me dy pika: Sigurimin e mjeteve për pagesën e kompensimit për anëtarët e Këshillit dhe ndarjen e mjeteve në bazë të kërkesës për donacion. Në bisedë me z.Trajçev, është parë mundësia që donacioni të ketë kahje drejtpërdrejt në një institucion publik shëndetësor, në vend të shoqatave të qytetarëve, si një zgjidhje potencialisht më e mirë. Ai theksoi se në këtë fazë propozohet miratimi i Planit Financiar të rishikuar, por pa marrë vendim konkret për donacion. Po ashtu, informoi se do të organizohet takim me drejtorin e institucionit publik shëndetësor dhe përfaqësues të shoqatave të qytetarëve, me qëllim që të konstatohet mundësia që donacioni të drejtohet në institucionin publik shëndetësor, duke shmangur pasojat e mundshme negative për Agjencinë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin miratohet ribalanci i Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025, nr.05-5307/1 datë 26.12.2024.

Shpenzimet në total të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, gjegjësisht arrijnë në 199.729.722,00 denarë.

Me ribalancin e propozuar parashihen mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 4.150.000,00 denarë, destinuar për:

- Pagesëtë kompensimit mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për muajt: janar, shkurt dhe mars 2025 në shumë prej 3.150.000,00 denarë dhe
- dhënien e ndihmës financiare - Donacion me rastin e Kërkesës së paraqitur nr.05-205/1 të datës 14.01.2025 nga Shoqata për përkrahje të pacientëve paliativë dhe familjeve të tyre Pallium Shkup në vlerë prej 1.000.000,00 denarë, për Projektin të Energjisë Efikase për NSHP SBGPM 13 Nëntori Shkup.

Detyrohet që Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozim-vendimin për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë. Ajo shpjegoi se në përputhje me nenin 79, paragrafi (3) të LSHMAAV, transmetuesi mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes në afat jo më gjatë se gjashtë muaj para skadimit të saj. Me këtë rast Televizioni Uskana nga Kërçova ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e lejes, e cila është e vlefshme në periudhën prej 24.06.2016 deri më 23.06.2025. Pas shqyrtimit të kërkesës u konstatua se ajo fillimisht ishte e paplotë, për këtë arsye u kërkua plotësimi i saj. Pas një rishikimi, u konstatua se kërkesa ishte në rregull dhe mund të procedohej. Po ashtu, është bërë inspektim në punën e transmetuesit gjatë kohëzgjatjes së lejes dhe është konstatuar se i plotëson të gjitha kushtet e parapara në nenin 79 të Ligjit dhe se nuk ka shkelje serioze në përputhje me paragrafin (4) nga Ligji i njëjtë. Në bazë të kësaj, propozohet dhënia e lejes së re me vlefshmëri prej nëntë vjetësh.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr. 08-353, datë 30.06.2016, për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare, për periudhën prej datës 24.06.2006 deri më 24.06.2020.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pikat 6, 7 dhe 8

Z. Petrushevski propozoi që pikat 6, 7 dhe 8 të shpjegohen në një hyrje pasi që kanë të bëjnë me të njëjtën medium, dhe votimi për secilën shkelje të jetë individual.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit,, Magdalena D. Dovleva, ka shpjeguar propozimet për vërejtje publike në lidhje me shkeljet e nenit 141 paragrafi (13), nenit 143 paragrafi (1) dhe nenit 144 paragrafi (3) të LSHMAAV. Ajo theksoi se mbikëqyrja është bërë javën e kaluar dhe ka qenë gjithëpërfshirëse në disa baza, nga ku është konstatuar se ky operator ka bërë tri shkelje të rregullave të punës. Shkelja e parë ka të bëjë

me ritransmetimin e 9 shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjenci. Shkelja e dytë u konstatua kur operatori transmetonte televizion vendas jashtë zonës për të cilën i ishte dhënë leja. Shkelja e tretë ka të bëjë me mospërputhje midis sinjalit dalës që operatori i dërgon Agjencisë dhe sinjalit që i ofron përdoruesve të tij. Në përputhje me ligjin, si masë fillestare për këto shkelje propozohet vërejtje publike.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore, nr.11-335/1 datë 23.01.2025 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivari t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 paragrafi (13) të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria për prodhim , tregti , hotelieri , transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivari, që sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryen veprimtari në territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçisht, Bogovinë dhe Kërçovë , më data 21.01.2025, për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore "HBO", "HBO 2", "ATV", "Hayat Folk Box", "Hayat 2", "Hayat Music Box", "Star", " Kanal D" dhe " Haberturk", të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi (13) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejta të autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 7

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme programore, nr.11-330/1 datë 23.01.2025 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivari t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 143 paragrafi (1) të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 07.11.2022, urdhërohet që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se operatori i rjetit publik të komunikimit elektronik Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivari, që sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund po kryen veprimtari në territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçisht, Bogovinë dhe Kërçovë, më territorin e komunës së Kërçovës ka ritransmetuar shërbimin

programor Tv Koha që nga Agjencia ka marrë leje për transmetimin në nivel rajonal për rajonin D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçishtë, Bogovinë, Bërvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelino), që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (1) të Ligjit.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të jashtëzakonshme programore, nr.11-328/1 datë 23.01.2025 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJ eksport-import Gostivari, t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 144 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe në përputhje me 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJ eksport-import Gostivari, që sipas notifikacionit (njoftimit) nga Agjencia për Komunikime Elektronike ka të drejtë të kryen veprimtari në territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçisht , Bogovinë dhe Kërçovë , drejtua Agjencisë nuk jep sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të përdoruesve, që është në kundërshtim me nenin 144 paragrafi (3).

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 9

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, Magdalena D. Dovleva, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për pagesën e mjeteve për qasje në Sistemin e Shpërndarjes së Internetit të Regjistrit Qendror. Ajo shpjegoi se ky shërbim është i nevojshëm për përmbushjen e kompetencave që dalin nga LSHMAAV, dhe se sektori e përdorur që nga viti 2017. Shërbimi funksionon sipas parimit të pagesës pripejd me parapagesë), ku mjetet paguhen dhe në varësi të përdorimit të shërbimeve, shuma zvogëlohet. Pagesa e mëparshme është kryer më 30 tetor 2023 në shumë prej 40.000,00 denarë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për pagesën e mjeteve për të dhënat e Qendrës së shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror të RSM-së, në shumë prej 40.000,00 denarë, me çka do të krijohen kushte për përmbushjen e vazhdueshme të detyrimeve që për Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale janë parashikuar në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizive dhe në Ligjin për Media

Shuma e lartpërmendur e mjeteve është parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025.

Pika 10

Të ndryshme

Z. Petrusevski informoi se Komisioni për zgjedhje dhe emërime sot ka propozuar përbërjen e re të anëtarëve të Këshillit të Agjencisë. Ai shpjegoi se propozimi do të vihet në seancë plenare dhe nëse votohet me minimum 80 vota dhe me shumicë Badener, do të realizohet. Në këtë drejtim, ai theksoi se kjo seancë mund të jetë e fundit me përbërjen aktuale dhe i falënderoi për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet anëtarëve të Këshillit. Ai përmendi se edhe pse shpesh nuk kanë pasur mendim të njëjtë dhe ndonjëherë kanë pasur dilema të ndryshme dhe debate konstruktive, ata kanë mbetur gjithmonë miq. Ai gjithashtu falënderoi për bashkëpunimin e gjatë me drejtorin, i cili investoi përkushtimin e tij maksimal për funksionimin e suksesshëm të Agjencisë, si dhe me Shërbimin Profesional, i cili në vazhdimisht ka treguar profesionalizmin e tij të lartë.

Z. Fidanoski falënderoi të gjithë anëtarët e Këshillit, si dhe drejtorin Zoran Trajçevski. Ai shpjegoi se kanë një bashkëpunim të shkëlqyer afatgjatë, i cili ka zgjatur për më shumë se dhjetë vjet. Ndonëse ndonjëherë ka pasur mosmarrëveshje mendimesh dhe diskutime më intensive, ato janë udhëhequr gjithmonë nga profesionalizmi dhe nuk e kanë kaluar asnjëherë "vijën e kuqe". Ai beson se bashkëpunimi ka ruajtur respektin dhe dinjitetin reciprok. Z. Fidanoski shtoi se të njëjtin respekt e ka edhe ndaj Shërbimit Profesional, me të cilin ka pasur bashkëpunim të mrekullueshëm, duke besuar se ndajnë të njëjtin mendim.

Z. Ajdini tha se si çdo punë ka një fund, ashtu ka edhe përbërja e këtij Këshilli. Ai falënderoi për bashkëpunimin korrekt me të gjithë anëtarët e Këshillit dhe të punësuarit.

Z. Trajçev përgëzoi propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit, me shpresën se ata do të vazhdojnë punën e suksesshme të Agjencisë, siç ka vepruar dhe kjo përbërje. Ai falënderoi të gjithë anëtarët e Këshillit, drejtorin dhe punonjësit e Agjencisë. Ai tha se gjatë bashkëpunimit të gjatë janë marrë vendime dhe rregullore të shumta, është vendosur sistemi i punës dhe është krijuar mundësia që Agjencia të strukturohet si organ profesional, institucion që shërben si shembull se si duhet punuar - profesionalisht, pa ndikim të jashtëm, qoftë nga anëtarët e Këshillit ose nga Drejtori. Sipas tij, me këtë organizim, në të ardhmen askush nuk mund të ndikojë në institucionin në kryerjen e detyrave të tij në përputhje me ligjin. Këtë, siç theksoi ai, e vërtetojnë edhe raportet pozitive ndërkombëtare për progresin e Agjencisë në fushën e funksionimit të saj.

Për bashkëpunimin me anëtarët e Këshillit, ai tha se kanë pasur debate të frytshme për shumë çështje dhe se është mirë që kanë pasur qëndrime të ndryshme në situata të shumta, ku secili ka shprehur mendimin e vet dhe ka vlerësuar argumentet e të tjerëve. Është nder për të që mes tyre nuk ka pasur luftë personale, por vetëm shkëmbim argumentesh, të

cilat janë mbështetur dhe pranuar nga anëtarët e tjerë. Kjo, sipas tij, dëshmon për nivelin e lartë të profesionalizmit që së bashku kanë arritur.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,d.v.**